



UNIVERSITETI POLITEKNIK - TIRANË  
SENATI AKADEMIK

## RREGULLORE

MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E  
SENATIT TË UPT

**Miratohet**

Kryetari i Senatit

Akademik Jorgaq KAÇANI

Tiranë, më \_\_\_\_\_ 2009

## "MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SENATIT AKADEMIK TË UPT"

### Neni 1

Senati Akademik është organ kolegjal vendimmarrës i zgjedhur në nivel Universiteti. Veprimtaria e Senatit të UPT, mbështetet në Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 14 si dhe në Statutin e UPT, neni 19.

### Neni 2

Senati është organi më i lartë i Universitetit që përcakton politikat e zhvillimit të tij, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor, problemet administrativo-financiare si dhe vlerëson efikasitetin e tyre.

### Neni 3

Drejtimet kryesore të veprimtarisë së Senatit, përfshijnë:

1. garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit, si dhe të drejtat e studentëve;
2. miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
3. vendos me shumicën e votave të anëtarëve të tij projektbuxhetin e UPT, pasi merr miratimin nga këshilli i administrimit;
4. miraton ndarjen e burimeve financiare;
5. miraton projektstatutin me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij;
6. miraton rregulloret që janë kompetencë e tij;
7. vlerëson dhe miraton programet e reja të studimit, të kërkimit e zhvillimit si dhe i propozon Ministrin të Arsimit dhe Shkencës hapjen apo mbylljen e programeve të reja të studimeve në universitet;
8. propozon hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësive mësimore dhe kërkimore;
9. vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me standardet shtetërore;
10. vlerëson veprimtarinë mësimore-kërkimore të personelit akademik;
11. siguron që kontrolli dhe vlerësimi i dijeve të bëhen në përputhje me standardet e shprehura në Rregulloren e Universitetit, duke garantuar cilësinë dhe transparencën e nevojshme.
12. i propozon Ministrin të Arsimit dhe Shkencës kuotat e pranimeve në Universitet, si dhe tarifat e regjistrimit dhe të studimeve;
13. kur e çmon të nevojshme, përcakton kritere të veçanta në përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve;
14. përcakton kriteret e pranimit për kandidatët në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve;

15. përzgjedh anëtarët e Këshillit të etikës akademike;
16. shfuqizon, kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit, vendimet e këshillit të fakultetit/institutit, kur bien ndesh me legjislacionin në fuqi;
17. kërkon mendimin e këshillit të administrimit për probleme që janë kompetencë e këtij të fundit.

#### **Neni 4**

Senati akademik kryesohet nga rektori, i cili është kryetar i tij. Në mungesë të tij mbledhjen e drejton nënkryetari.

#### **Neni 5**

Senati akademik përbëhet nga 38 anëtarë të brendshëm, të zgjedhur, si përfaqësues të grupimeve përkatëse të Universitetit sipas nenit 19, pika 4, të statutit të UPT, + 1 (Rektori) që le detyrën në zgjedhjet e radhës.

#### **Neni 6**

Senati akademik ka sekretarin/en e vet shkencor/e, i cili/e cila është Kryetari/ja i/e Degës Shkencore që merr pjesë në mbledhjet e Senatit dhe bën zbardhjen e vendimeve të tij, mbi bazën e proces-verbalit të mbajtur në mbledhje.

#### **Neni 7**

Në mbledhjet e Senatit merr/marrin pjesë Zv/rektori (Zv/Rektorët) pa të drejtë vote, kur nuk është/janë anëtarë të zgjedhur të senatit akademik. Në mbledhjet e Senatit merr pjesë, pa të drejtë vote, edhe Kancelari i Universitetit.

#### **Neni 8**

Dekani/Drejtori i njësisë kryesore është anëtar i senatit akademik dhe përfshihet në numrin e përfaqësuesve të çdo fakulteti/instituti.

#### **Neni 9**

Anëtarët e brendshëm të senatit akademik zgjidhen sipas procedurave të përcaktuara në statutin e UPT dhe në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

#### **Neni 10**

Për të lehtësuar funksionimin e brendshëm të Senatit Akademik, për vlerësimin paraprak të propozimeve që i paraqiten atij, krijohen komisionet e përhershme të senatit:

1. Komisioni i mësimit dhe currikulave
2. Komisioni i buxhetit dhe investimeve
3. Komisioni i kërkimit shkencor dhe kualifikimit
4. Komisioni i ligjshmërisë dhe rregulloreve

Komisionet zgjedhin kryetarin e tyre.

#### **Neni 11**

Komisionet e përhershme përbëhen, si rregull, nga anëtarë të zgjedhur të Senatit. Në përbërje të tyre mund të përfshihen edhe specialistë të fushave përkatëse, por gjithmonë jo më shumë se 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të komisionit dhe në asnjë rast nuk i kryesojnë këto komisione. Përbërja e komisioneve propozohet nga Rektori dhe miratohet nga Senati.

#### **Neni 12**

Për probleme specifike, me propozim të Kryetarit të Senatit, krijohen komisione të përkohshme, përbërja dhe mandati i të cilëve përcaktohen në vendimin përkatës të Senatit.

#### **Neni 13**

Senati mblidhet, në seanca të zakonshme, së paku një herë në dy muaj, në përputhje me programin e punës të publikuar në fillim të çdo viti akademik.

#### **Neni 14**

Senati mund të mblidhet edhe në seanca të jashtëzakonshme, me iniciativën e kryetarit të senatit ose me kërkesën e një të tretës së anëtarëve të tij. Në rastin kur senati mblidhet me kërkesën e një të tretës së anëtarëve të tij, rendi i ditës propozohet nga grupi i anëtarëve propozues.

#### **Neni 15**

Mbledhjet e senatit dhe të komisioneve të tij, janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të brendshëm të tij. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të të pranishmeve në mbledhje.

Për rastet kur kërkohen ndryshime të Statutit të UPT apo të Rregulloreve të tij, vendimet merren me jo më pak se 2/3 e votave "pro" të anëtarëve të senatit.

#### **Neni 16**

Votimet në senat, si rregull, bëhen të hapura. Në rast se votat pro dhe kundër, për një çështje të caktuar, janë në numër të barabartë, vendimtare është vota e Kryetarit të Senatit. Votimet në senat mund të bëhen edhe të fshehta, kur kjo kërkohet nga Kryetari i Senatit ose nga një e treta e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

#### **Neni 17**

Mbledhjet e Senatit thirren me një rend dite të përcaktuar, propozuar nga kryetari. Njoftimi për mbledhjen e Senatit u dërgohet anëtarëve të tij, pasi janë shprehur komisionet, jo më pak se shtatë ditë nga data e zhvillimit të mbledhjes. Njoftimin e organizon rektorati.

#### **Neni 18**

Materialet që i paraqiten për shqyrtim Senatit, vlerësohen paraprakisht nga

komisionet e përleshme të tij, të cilët u bëjnë sugjerimet përkatëse autorëve të materialit dhe i shprehin Senatit me shkrim vlerësimin e tyre. Në rast se komisioni nuk bie dakord me një material të caktuar ka të drejtë ta kthejë atë për ripunim. Koha e ripunimit është jo më pak se një javë. Këtë të drejtë komisioni e ka vetëm një herë. Nëse edhe pas ripunimit komisioni ka vërejtje serioze për materialin ai është i detyruar ta përcjellë atë në Senat dhe të shprehë atje me shkrim kundërshtimet e veta.

#### **Neni 19**

Materialet që do të shqyrtohen në mbledhjen e Senatit, sipas specifikave që kanë, depozitohen në rektorat dhe/ose ju dërgohen anëtarëve të Senatit.

#### **Neni 20**

Procedura e mbledhjes së Senatit dhe diskutimet e zhvilluara në të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga mbajtësi i tij. Proces-verbalet e mbledhjeve të Senatit arkivohen.

#### **Neni 21**

Para fillimit të mbledhjes së Senatit anëtarët e tij regjistrojnë emrin për diskutim në sekretari. Për diskutimin e çdo pike të rendit të ditës fjala merret vetëm një herë. Përfundim bëhet vetëm kur kërkohet fjala në rast replike.

#### **Neni 22**

Vendimet e senatit nënshkruhen nga kryetari i tij dhe bëhen publike brenda 3 ditëve nga përfundimi i mbledhjes përkatëse. Vendimet hartohen në dy kopje, njëra prej të cilave arkivohet dhe tjetra i dërgohet njësisë/njësive përkatëse për zbatim. Vendimet e Senatit afishohen edhe në Web-in e Universitetit.

#### **Neni 23**

Senati i UPT funksionon dhe ka fuqi ligjore vendim-marrëse brenda hapësirës kohore të legjislaturës, për të cilën është zgjedhur. Në raste të veçanta kjo hapësirë kohore mund të tejkalohet, por në çdo rast mandati Senatit Akademik përfundon me mbledhjen e parë të Senatit të Ri.

#### **Neni 24**

Me propozim të Kryetarit, Senati i heq mandatin e anëtarit personit që:

1. largohet nga UPT;
2. jep dorëheqjen;
3. nuk merr pjesë për 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme, në mbledhjen e Senatit;
4. për arsye shëndetësore ose largimi për një kohë të gjatë jashtë shtetit e bën të pamundur pjesëmarrjen e tij në Senat.

Në raste të tilla fiton mandatin e anëtarit të Senatit personi që, në grupimin përkatës,

pason fituesin e mëparshëm

**Neni 25**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit në Senatin Akademik dhe firmosjes nga Kryetari i tij.

Miratuar me Vendimin Nr. 9 të Senatit Akademik, datë 02.02.2009